

Nr prot 685
4.10.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
MINISTRI

Nr. 3480 Prot.
u

Tiranë, më 05.07 .2021

Lënda: Dërgohet mendim për një projektvendim.

ZNJ. ERIDA SKËNDAJ
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ✓

Z. HELIDON BENDO
SHËRBIMI INFORMATIV SHTETËROR

Tiranë

Bashkëlidhur, ju dërgojmë për mendim projektvendimin e Këshillit të Ministrave "Për kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të komisionit kombëtar për azilin dhe refugjatët", së bashku me relacionin shpjegues.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

MINISTRI

BLENDAR ÇUÇI



RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR KRITERET E EMËRIMIT, SHKAQET E LIRIMIT APO TË SHKARKIMIT, SI DHE SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR PËR AZILIN DHE REFUGJATËT”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i projektvendimit është krijimi i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, si autoriteti i vetëm kompetent vendimarrës për ankimet kundër vendimeve të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, si dhe përcaktimi i kriterëve të emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të komisionit kombëtar për azilin dhe refugjatët.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektakti i propozuar për miratim, është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave, për Ministrinë e Brendshme, për vitin 2021 dhe është në zbatim të ligjit nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektvendimi propozohet me qëllim krijimin, përbërjen, kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, shpërblimi i anëtarëve të komisionit kombëtar për azilin dhe refugjatët si dhe funksionimi i tij si shkallë e parë ankimi, ndaj të gjitha vendimeve të dhëna nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët. Kjo mënyrë organizimi i siguron kërkuesit dhe atyre që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare, që me ligj i lind e drejta e ankimit, ezaurimin e rrugës administrative të ankimit, para një autoriteti të përbërë nga anëtarë që mbulojnë fushat, me të cilat lidhen të drejtat që përfitojnë të huajt apo personat pa shtetësi që janë subjekt i ligjit nr. 10/2021 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë, para ankimit në Gjykatën administrative kompetente.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi është mbështetur në nenin 100-të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 78, të ligjit nr 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi “Për kriteret e emërimit, shkaqet e lirimit apo të shkarkimit, si dhe shpërblimi i anëtarëve të komisionit kombëtar për azilin dhe refugjatët”, përbëhet nga 17 pika. Në vijim jepet përmbledhja shpjeguese e secilës prej tyre.

Në pikën 1, është parashikuar krijimi i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, i cili është autoriteti i vetëm kompetent vendimmarrës mbi ankimimet e bëra ndaj vendimeve të autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

Në pikën 2, është parashikuar përbërja e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, me përfaqësues të Ministrive dhe institucioneve, të cilat do të jenë pjesë e tij. Komisioni kryesohet nga Komisioneri Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, i cili është përfaqësues i kategorisë së lartë drejtuese (anëtar i TND), në Ministrinë përgjegjëse për azilin dhe refugjatët. Përfaqësuesit e ministrive, SHISH dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit, anëtarë të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, janë caktuar duke patur parasysh fushën e përgjegjësisë shtetërore të tyre, në raport me të drejtat që përfitojnë kërkuesit dhe personat që kanë fituar statusin e mbrojtjes ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

Në pikën 3, është përcaktuar se, Komisioni gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, do të asistohet nga një specialist i autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, me detyrën e sekretarit.

Në pikën 4, është parashikuar funksionimi i Komisionit sipas një rregulloreje, të miratuar me shumicë votash nga anëtarët e tij, e cila do të bazohet në ligjin 10/2021 “Për Azilin në R.SH”, në ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe në ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i R.SH”.

Në pikën 5 përcaktohen kompetencat e Komisionerit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët.

Në pikën 6, është parashikuar emërimi i Anëtarëve të Komisionit të cilët propozohen nga institucionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të cilët kanë mandat 4 (katër) vjeçar me të drejtë riemërimi. Përfundimisht, kur vërtetohen shkaqet e përcaktuara në pikën 8 (tetë) dhe 9 (nëntë).

Në pikën 7, janë përcaktuar kriteret e emërimit që duhet të plotësojnë anëtarët e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët.

Në pikat 8 dhe 9, janë përcaktuar respektivisht rastet e lirit dhe shkarkimit nga detyra e anëtarëve të këtij komisioni.

Në pikën 10 është parashikuar shpërblimi i anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët si dhe sekretarit të këtij Komisioni.

Në pikën 11, është parashikuar shpërblimi i anëtarëve të komisionit, i cili nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) shpërblime brenda 1 (një) viti, pavarësisht nga numri i mbledhjeve.

Në pikat 12, 13 dhe 14 të këtij projektvendimi, është parashikuar funksionimi tij, duke filluar me dokumentacionin e plotë të kërkuarit, që i vihet në dispozicion nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, parimet që zbatohen nga Komisioni, marrja e vendimit dhe komunikimin e tij, të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente për çështjet administrative dhe vulosjen e vendimeve të Komisionit, me vulën e Ministrisë përgjegjëse për azilin dhe refugjatët.

Në pikën 15, është parashikuar shfuqizimi i Vendimit nr. 206 datë 16.03.2016, i Këshillit të Ministrave "Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit Kombëtar për azilin dhe refugjatët".

Në pikën 16, janë përcaktuar institucionet e ngarkuara me zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është hartuar nga Ministria e Brendshme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektvendim shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit, në lidhje me shpërblimet e parashikuara për anëtarët e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët. Është parashikuar që numri maksimal i pagesave në një vit të jetë 12 (dymbëdhjetë). Ky komision përbëhet nga Kryetari, 4 (katër) anëtar dhe 1 (një) sekretar. Masa e shpërblimit për Komisionerin është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje, për anëtarët e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje dhe për Sekretarin e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.

Shpenzimet për kryerjen e pagesës së anëtarëve në përbërje të këtij komisioni, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit të pjesëmarrjes në mbledhje, përballohen nga buxheti i institucioneve të secilit anëtar.

PROPOZUESI

MINISTRI

BLEDAR ÇUÇI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2021

“PËR

KRITERET E EMËRIMIT, SHKAQET E LIRIMIT APO TË SHKARKIMIT, SI DHE SHPËRBLIMI I ANËTARËVE TË KOMISIONIT KOMBËTAR PËR AZILIN DHE REFUGJATËT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 78, të ligjit nr 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Krijimin e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët (në vijim “Komisioni”), si organ administrativ epror, kompetent dhe vendimmarrës, për shqyrtimin e ankimeve ndaj vendimeve të Autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët.
2. Komisioni kryesohet nga Kryetari i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët (në vijim “Komisioneri”), i cili është nëpunës civil i kategorisë së lartë drejtuese (anëtar i TND). Komisioneri propozohet nga ministri përgjegjës për çështjet e azilit dhe është një prej anëtarëve të këtij Komisioni. Komisioni përbëhet nga:
 - një përfaqësues i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
 - një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
 - një përfaqësues i Shërbimit Informativ të Shtetit;
 - një përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Helsinkit.
3. Komisioni, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, asistohet nga një specialist i autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, me detyrën e sekretarit, i cili caktohet nga drejtuesi i këtij autoriteti.
4. Komisioni funksionon në bazë të rregulloreve të brendshme, për organizimin dhe funksionimin e tij, të miratuar me shumicën e votave të anëtarëve të tij.

5. Komisioneri drejton mbledhjet dhe diskutimet e Komisionit, duke garantuar vendimarrjen në përputhje me legjislacionin kombëtar për azilin dhe refugjatët.
6. Anëtarët e Komisionit propozohen nga institucionet e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi dhe miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, të cilët kanë mandat 4 (katër) vjeçar me të drejtë riemërimi. Përfundimisht, kur vërtetohen shkaqet e përcaktuara në pikën 8 (tetë) dhe 9 (nëntë).
7. Kriteret e emërimit që duhet të plotësojnë anëtarët e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, janë si më poshtë vijon:
 - a) të jenë diplomuar në shkencë shoqërore;
 - b) të jenë nëpunës civil ose në pozicione ekuivalente jashtë shërbimit civil, të paktën, të nivelit të mesëm drejtues;
 - c) të kenë eksperiencë profesionale jo më pak se 5 (pesë) vjet në administratën shtetërore ose në institucione të barazvlefshme me të;
 - d) të pajisen me Çertifikatë Sigurie, niveli "Sekret".
8. Anëtari i Komisionit lirohet nga detyra në rastet kur:
 - a) mbaron mandati;
 - b) jep dorëheqjen;
 - c) përfundon marrëdhënia e punës me institucionin që ai përfaqëson;
9. Anëtari i Komisionit shkarkohet nga detyra në rastet kur:
 - a) nuk merr pjesë, pa arsye, në mbledhjet e Komisionit për më shumë se dy herë radhazi;
 - b) veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë e Komisionit;
 - c) nuk ruan konfidencialitetin e informacioneve ose i përdorin ato për interesa personale;
 - d) dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
 - e) ushtron veprimtarinë në kushtet e konfliktit të interesit.
10. Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët:
 - 10.1 Masa e shpërblimit për Komisionerin është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për çdo mbledhje.
 - 10.2 Masa e shpërblimit për anëtarët e Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët është 5 000 (pesë mijë) lekë për çdo mbledhje.
 - 10.3 Sekretari i Komisionit Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët merr një shpërblim në masën 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë për çdo mbledhje.
 - 10.4 Shpenzimet për kryerjen e pagesës së anëtarëve dhe sekretarit përballohen nga buxheti i institucioneve të secilit prej tyre, të cilat vërtetohen kundrejt dokumentit pjesmarrës në mbledhje.

11. Shpërblimi i anëtarëve të komisionit nuk mund të jetë më shumë se 12 (dymbëdhjetë) shpërblime brenda 1 (një) viti, pavarësisht nga numri i mbledhjeve.
12. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët i paraqet Komisionit dokumentacionin e plotë të kërkuarit për mbrojtje ndërkombëtare, i cili ankimon vendimin e dhënë nga ky autoritet.
13. Komisioni merr vendim brenda 30 ditëve, nga data e paraqitjes së ankimi, ose brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit kundër vendimeve të marra në mbështetje të neneve 35 dhe 36 të ligjit të posaçëm për azilin. Vendimi i arsyetuar i Komisionit i dërgohet kërkuarit të mbrojtjes ndërkombëtare, nëpërmjet autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, dhe është përfundimtar, lidhur me ankimin administrativ. Ky vendim mund të ankimohet nga kërkuari i mbrojtjes ndërkombëtare në gjykatën kompetente për çështjet administrative, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
14. Vendimet e Komisionit marrin vulën e ministrisë përgjegjëse për çështjet e azilit.
15. Vendimi nr. 206, datë 16.03.2016, i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Komisionit Kombëtar për azilin dhe refugjatët”, shfuqizohet.
16. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA